

## Konkurs

**Pozita:** Kryeshef Ekzekutiv

**Kohëzgjatja:** 3 vjet

**Data e fillimit:** Pas përzgjedhjes

### Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës

Kryeshefi Ekzekutiv i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, SH.A. (ANP) i raporton Bordit të Drejtorëve, dhe do të jetë përgjegjës për menaxhimin ANP përfshirë zhvillimin strategjik, financiar dhe komercial si dhe operacionet e përditshme të ANP përfshirë ofrimin e shërbimeve optimale për konsumatorët e ANP, shërbimet e trafikut ajror, për partnerët afaristë dhe palët e tjera të kyçura me qëllim të ofrimit të shërbimeve të sigurta, efikase dhe dobiprurëse sipas misionit dhe objektivave të Kompanisë.

Kryeshefi Ekzekutiv po ashtu do të sigurojë se implementimi i Programit të ANP për Siguri të jetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare, legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe kriteret të tjera të definuara shtetërore.

### Fushëveprimi i kësaj pozite është me sa vijon:

- Implementimi i Politikave dhe Administrimi
- Menaxhimi dhe Mbikëqyrja
- Koordinimi dhe Ndërlidhja


### Implementimi i Politikave dhe Administrimi

Të veprorë si anëtar i Bordit të Drejtorëve të ANP dhe të ekzekutojë në emër të tij direktivat, rezolutat dhe vendimet e tij;

- T'i rekomandojë Bordit të Drejtorëve udhëzime strategjike dhe të politikave, plane dhe programe operationale, afariste dhe zhvillimore, buxhete operationale dhe investuese si dhe Planet e Burimeve Njerëzore dhe shkallën e pagesës (shpërblimit);
- Të sigurojë që standardet e sigurisë në ANP të përmbushin kriteret ndërkombëtare me qëllim të minimizimit të çdo rreziku të mundshëm për klientelën e ANP. Në këtë kontekst të sigurojë funksionimin e duhur të sistemit menaxhues të sigurisë në ANP;

### Menaxhim dhe Mbikëqyrje

- Të mbikëqyrë operacionet e përditshme dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe shërbimeve të ANP, përfshirë të gjitha aktivitetet e trajtimit të pasagjerëve, shërbimet e trafikut ajror dhe pajisjeve që lidhen me lëvizjen e fluturakeve, pasagjerëve dhe ngarkesave (kargos);
- Të mbikëqyrë dhe monitorojë kualitetin e shërbimeve të ANP dhe të raportojë mbi progresin dhe përmirësimet e nevojshme krahasuar me nivelet e synuara të caktuara nga menaxhmenti në bashkërendim me Bordin e Drejtorëve.



- Të mbikëqyrë zhvillimin dhe implementimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të marketingut, e cila do të mundësojë arritjen e vizionit strategjik të Kompanisë për ta vënë ANP në ballë të të gjithë shërbyesve të aviacionit njashu edhe pajisjet/shërbimet e ANP në rajonin e Ballkanit.
- Të mbikëqyrë planifikimin dhe implementimin e programeve promovuese të marketingut dhe atyre të lidhura me aviacionin me qëllim të zgjerimit të shërbimeve të ofruara nga ANP dhe të përfitimeve të Kompanisë.
- Të jetë plotësisht i përgjegjshëm dhe të marrë pjesë në zhvillimin komercial të ANP-së në joshjen e trafikut më të madh dhe të kargos si dhe të hulumtojë burime të tjera të të hyrave si shitjet pa taksa doganore (duty-free), të hyra nga qiraja e pronës dhe kuotat e koncesionit duke pasur parasysh arsyeshmërisë ligjore, kërkesën ekzistuese dhe të pritur, qëndrueshmërinë financiare dhe kthimin e pritur të investimeve të mundshme.
- Të zhvillojë më tej një Sistem Menaxhimi efikas dhe të efektshëm të intervaleve në bashkëpunim me të gjithë transportuesit e planifikuar dhe ata me qira (charter) në ANP me qëllim të minimizimit të tolloive të mëdha të trafikut në periudhat e qarkullimit të lartë, të sigurojë një nivel të vazhdueshëm të shërbimeve optimale të klientela e ANP, të kënaqë kërkesat specifike për ndonjë termin për aq sa të jetë praktike dhe të përmirësojnë punën e përgjithshme të Kompanisë;
- Të sigurojë menaxhim të duhur të fondeve dhe asetëve sipas autoritetit të deleguar dhe në përputhje me rregullat në fuqi të menaxhimit të llogaridhënies për financat publike.
- Të mbikëqyrë zhvillimin dhe implementimin e një programi efektiv publik dhe për marrëdhënie me komunitetin që përqendrohet në promovimin e objektivave të ANP;


### **Koordinimi dhe ndërlidhja**

- Të përfaqësojë interesat e ANP SH.A. në përmasa vendore dhe ndërkombëtare sidomos gjatë takimeve të rregullta ose të atypëratyshme të komisioneve të shfrytëzuesve (Komisionit të Operatorëve të ANP, Komisionit për dhe Siguri, takimet ose kuvendet e Këshillit Ndërkombëtar të ANP, etj);
- Të veprojë si ndërlidhje e aeroportit me Autoritetin e Aviacionit Civil, operatorët e aeroportit dhe qiraxhinjtë, departamentet e shërbimeve publike të aeroportit, Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe KFOR-it për çështje që lidhen me shërbimet, operacionet dhe zhvillimin e aeroportit.
- Të caktojë, zhvillojë dhe udhëheqë aktivitetet e komisioneve përkatëse të aeroportit në fushat si siguria e hapësirës ajrore, siguria, pajisjet dhe operacionet e Aeroportit;
- Të shërbejë si ndërlidhje me të gjithë përfaqësuesit relevantë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe kompanive nga sektori privat ose organizatave për të siguruar operacione efikase dhe efektive të ANP.

### **Kriteret/kualifikimet profesionale**

Kandidati i suksesshëm duhet të jetë:

Person me integritet të njohur i/e cili/a, sipas Ligjit nr.03/L-087 “Për Ndërmarrjet Publike”, Nenit 17.1, i plotëson kushtet e kualifikimit, dhe sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (I) i plotëson kriteret e pavarësisë;



Kandidati i suksesshëm duhet të ketë:

- Diplomë universitare relevante, në fushën e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë, jurisprudencës apo aviacionit.
- Së paku pesë (5) vite përvojë në një nivel të lartë të menaxhmentit; në industrinë e aviacionit, fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financave, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër të shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.
- Të ketë njohuri për dokumentacionin, doracakët, shtojcat, standardet dhe praktikat e rekomanduara të ONAC-s (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil), e sidomos në ANP dhe shërbimet e trafikut ajror;
- Të ketë njohuri të mira për çështjet afariste dhe komerciale në përputhje me legjislacionin pozitiv në Republikën e Kosovës;
- Iniciative, takt dhe shkathtësi për të mbajtur marrëdhënie pune të mira me punëtorët, sindikatat e punëtorëve, klientët, eprorët dhe stafin menaxhues;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme në komunikim dhe në negociim;
- Kandidati përveç që duhet të njohe gjuhës zyrtare të Republikës së Kosovës preferohet të njohe edhe gjuhën angleze;
- Shkathtësi të punojë me efikasitet në një mjedis shumetnik dhe shumë kulturor.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Aplikacioni i ANP së
2. CV
3. Diploma Universitare (kopje)
4. Vërtetim që kandidati nuk është nën hetime
5. Certifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës ( kopje)

Aplikacioni merret në webfaqen e ANPsë: [www.airportpristina.com](http://www.airportpristina.com) , ndërkaq dorëzohet në zyrën e Sekretares së Kompanisë, znj. Shqipe Devaja , në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës sh.a., Ndërtesa e Drejtorisë, 10070 Vrellë, Lipjan, Republika e Kosovës.

Konkursi është i hapur prej datës 12 Janar 2010, deri në 10 Shkurt 2010, ora 16:00.

